



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 88, datë 26.07.2022

PËR

MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019", DUKE PËRFSHIRË ZNJ. KLEVA HOXHA

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", Ligjit nr.44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr.97/2019, Ligjit nr. 22, datë 03.05.2018 "Për strehimin social", VKM nr. 301 datë 15.04.2020, "Për normat e strehimit", VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të proçesit të rindërtimit", VKM nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", i ndryshuar, VKM-së nr. 329, datë 16.05.2021 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë", shkresës me nr. 5933/2, datë 07.07.2022 të kryetares së Bashkisë Durrës, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i proçesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, l.17, rruga "Lura", pallatet nr.1&3, dhe rruga "Ahmet Dakli", pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26

nëntor 2019”, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës si edhe sipas relacionit të 2 komisioneve të përhershëm të këshillit, me propozim të Komisionit të Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike,


KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtesë në Aneksin nr.1 “Subjekt përfitues tek L.17, Rruga “Lura”, pallati 3, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, l.17, rruga "Lura", pallatet nr.1&3, dhe rruga "Ahmet Dakli", pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.32, datë 26.03.2021, përsa i përket klasifikimit si përfitues të znj. Kleva Hoxha, znj.Gioela Pepici, z. Daniel Pepici, znj. Enrina Pepici në masën e strukturës së njësisë së banimit 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe për Zgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 631 / prot.

9



Durrës, më 10.08.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.88 datë 26.07.2022 Për miratimin e një shtesë në aneksin nr.1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, Lagj.17, rruga Llura”, pallatet nr.1&3, dhe rruga "Ahmet Dakli", pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke përfshirë Znj. Kleva Hoxha

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

